

<p style="text-align: center;"><b>ELIMINIMI DHE TAKSA</b> <b>PËR MBETURINAT SHTËPIAKE DHE MBETURINAT TJERA</b></p>
--

**Në vëmendje të komuniteteve të huaja të Delémont-it**

**PARATHËNJE**

Komuna e Delémont-it bënë një politikë që synon kufizimin e prodhimit të mbeturinave, promovimin e klasifikimit dhe vlerësimit të tyre.

Ajo organizon eliminimin (zhdukjen) e mbeturinave të ngurta dhe të lëngshme, e ne veçanti mbeturinat urbane ,në të gjithë teritorin e saj. Ajo e bën edhe mbikëqyrjen.

Ajo informon popullsinë dhe bizneset për mundësitë riciklimit (vlerësimit) dhe ngre ndërgjegjësimin në lidhje me rëndësinë menaxhimit të duhur të mbeturinave.

**TAKSA VJETORE**

Taksa vjetore mbledhët për të mbuluar shpenzimet lidhur me mbeturinat e renda,të metaleve,të qelqit,të pet-it,të letres,e posaçërisht për mledhjen,transportin, djegjen,kompostimin dhe riciklimin e mbeturinave të tjera.

Shuma e taksës vjetore për person,kapë vlerën prej :

- |   |            |
|---|------------|
| - qifti i martuar   | fr. 180.-- |
| - personi i vetëm i moshës mbi 17 vjet e më të ardhura të tatueshme | fr. 90.--  |

Dyqanët dhe bizneset kanë tarifa të diferencuara,sipas madhësisë së tyre.

**TAKSA PËR THES**

**E HYRË NË FUQI PREJ : 1 KORRIKUT 2001**

Taksa për thes mblidhet për t'i mbuluar shpenzimet lidhur me mbeturinat shtëpiake,e posaçërisht për grumbullimin ,transportin dhe djegien e tyre.

Vetëm thasët e taksuar me ngjyrë **hiri të ndritëshme** të mbyllur,mbartës të shenimit « **SEOD** » në ngjyrë të gjelbër,do të merrën nga grumbulluesit.

Shuma (qmimi) jashtë taksës për thes arrin vlerën prej :

- 1.10 chf. për një thes të 17 litrave
- 2.15 chf. për një thes të 35 litrave
- 3,85 chf. për një thes të 60 litrave
- 7.30 chf. për një thes të 110 litrave
- 393.60 chf për ton të kontejnerët më chip elektronik të SEOD-it

Janë paraparë dispozita të veçanta për foshnjët dhe përsoneat që vuajnë nga derdhja e pavullnetshme e urinës.

Thasët e taksuar janë në shitje, në rrotulla pre 10 copësh, në shumicën e shitoreve të Delémont-it.

## **DEPNIMI (HUDHJA) E EGËR**

Në tërë territorin e komunë është e ndaluar braktisja (hudhia) e mbeturinave ndotëse të ngurta apo të lëngshme të çfardo lloji.

Është rreptësisht e ndaluar për t'i vendosur thasët e zakonshem të mbeturinave në vendet e grumbullimit. Ata që e shkelin këtë rregullore rrezikojnë gjobë prej fr. 100.-. Ne gjithashtu ju përkujtojmë së personat të cilët i perdorin këta thasë për t'i bartur mbeturinat e riciklueshme ( të qelqit, pet-it, kanaqeve, etj.), luten që t'i marrin thasët përsëri me veti..

## **NJOFTIME**

Departamenti I Planifikimit, Mjedisit dhe Punëve Publike është në dispozicionin tuaj për çdo informacion plotësues në numër të telefonit 032 / 421.92.92 dhe ju falënderon për bashkëpunimin tuaj të çmueshëm.

*Aneks :*

*- Sqarimet tjera për programin e grumbullimit të mbeturinave*

1 janvier 2019/UETP

Albanais\_introduction\_programme\_déchets\_Delémont\_2019.docx